

Informator për pajisje me pasaportë

Procedura e pajisjes me pasaportë të Republikës së Kosovës sipas Udhëzimit Administrativ MPB Nr. 06 / 2018

- **Procedura e aplikimi për pajisje me pasaportë për personat nën moshën 18 vjeçare :**

Aplikuesi duhet të jetë prezent personalisht në Qendrën për Pajisje me Dokumente i shoqëruar nga përfaqësuesi ligjor (dy prindërit / kujdestari) dhe duhet të paraqes dokumentet si në vijim:

- Ekstraktin origjinal apo kopje të tij për shikim për aplikuesin nën moshën 16 vjeçare;
- Letërnjoftimin e vlefshëm të Republikës së Kosovës për aplikuesit nga mosha 16 vjeçare;
- Pasaportën origjinale për shikim, në rast të ripërtëritjes. Në rast të ndërrimit të të dhënave në pasaportë, kërkohet edhe ekstrakti;
- Raportin/vërtetimin policor origjinal apo kopjen e noterizuar nga origjinali, në rast të humbjes/vjedhjes. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare;
- Raportin mbi konfiskimin nëse pasaporta është e konfiskuar jashtë vendit. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, duhet të jete i përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare. Nëse nuk e posedon raportin, aplikuesit/prindërit/kujdestarit i merret deklarata plotësuese/sqaruese;
- Dëshminë për identitetin e prindërve (letërnjoftim ose pasaportë) së paku njëri prind duhet të posedoj letërnjoftimin/pasaportën të vlefshme të Republikës së Kosovës;
- Nëse mungon njëri prind kërkohet autorizimi origjinal dhe i vulosur nga noteri, apo nga gjykata, ose kopja e noterizuar nga origjinali. Nëse autorizimi është në gjuhë të huaj, duhet të jete i përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare.
- Përfundimisht nga nën-nen paragrafi 1.1.7 i këtij neni, në rast kur njëri prind nuk ka mundësi të autorizoj prindin tjetër për arsye shëndetësore e që dëshmohet me dokumentacion nga institucioni përkatës, aplikuesin mund ta shoqëroj vetëm njeri prind;

- Nëse njëri prind ka vdekur, aplikuesi shoqërohet nga prindi tjetër. Vdekja dëshmohet me certifikatën e vdekjes;
- Nëse prindërit nuk jetojnë bashkë, kërkohet vendimi për kujdestarinë nga gjykata ose pëlqimi nga Qendra për Punë Sociale;
- Nëse prindërit e aplikuesit janë liruar nga shtetësia e Kosovës duhet të ofrojnë dokumente për identitetin e tyre;
- Nëse aplikuesi është i lindur në Republikën e Kosovës nga prindërit me shtetësi të huaj, ndërsa aplikuesi ka fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, prindërit duhet të paraqesin dëshmi të identitetit të tyre si dhe vendimin e shtetësisë për aplikuesin
- Dëshminë për pagesë 20 Euro (të cilën e merr gjatë aplikimit në sportel)

Përjashtim nga kjo procedurë bëjnë personat nën moshën 18 të cilët kanë fituar zotësi të veprimit sipas vendimit të lëshuar nga organi kompetent.

Tërheqja e pasaportës për personat nën moshën 18 vjeçare: mund të bëhet nga njëri prind / kujdestar pa prezencën e fëmijës duke dëshmuar dokumentet si në vijim:

- Dokument identifikimi i prindit/ kujdestarit
- Ekstraktin nga RQGJC i aplikuesit;
- Pasaportën paraprake të aplikuesit;

Tërheqja e pasaportës për personat nga mosha 16 vjeçare mund të bëhet personalisht nga aplikuesi duke prezantuar letërnjoftimin e vlefshëm.

- **Procedura e aplikimit për pajisje me pasaportë për personat nga mosha 18 vjeçare:**

Aplikuesi duhet të jetë prezent personalisht në Qendrën për Pajisje me Dokumente dhe duhet të paraqes dokumentet si në vijim:

- Letërnjoftimin e vlefshëm të Republikës së Kosovës në shikim;
- Pasaportën origjinale për shikim për aplikim, në rast të ripërtëritjes apo ndërrimit të të dhënave në pasaportë;
- Raportin/vërtetimin policor origjinal apo kopjen e notërizuar nga origjinali, në rast të humbjes/vjedhjes të pasaportës. Nëse raporti/vërtetimi është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare;

- Raportin mbi konfiskimin nëse pasaporta është e konfiskuar jashtë vendit. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer në një të njëzgjatë zyrtare. Nëse nuk e posedon raportin, aplikuesit i merret deklarata plotësuese / sqaruese.
- Dëshminë për pagesë 30 Euro (të cilën e merr gjatë aplikimit në sportel).
- Për pensionistë është 15 Euro

Tërheqja e pasaportës për personat nga mosha 18 vjeçare:

Bëhet personalisht nga aplikuesi ose me autorizim original të vërtetuar nga noteri apo gjykata

Me rastin e tërheqjes së pasaportës aplikuesi / i autorizuari duhet të paraqes:

- Letërnjoftimin e vlefshëm të aplikuesit
- Pasaportën paraprake të aplikuesit
- Dokument identiteti të të autorizuarit (letërnjoftim, pasaportë apo dokument tjetër me fotografi, i vlefshëm i lëshuar nga Republika e Kosovës);

Shënim: Aplikimi mund të bëhet në të njëjtën kohë për letërnjoftim dhe pasaportë në çdo Qendër për Pajisje me Dokumente

Shënim: Sipas UA MPB Nr. 07/2017 , pasaporta mund të merret me procedurë të përshpejtuar në afati kohor brenda 72 orë (llogariten vetëm ditët e punës) , tarifa shtesë është 50 Euro.